



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Seanca plenare e Kuvendit

SP-004

Prishtinë, më 3 tetor 2017, në orën 10:00

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 3 TETOR 2017**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetarët e Kuvendit, Xhavit Haliti dhe Mufera Srbica-Shinik.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2017.

Në fillim të seancës Kuvendi mbajti nga një minutë heshtje në nderim të viktimave të sulmit në Las Vegas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe për vdekjen e albanologut Robert Elsie.

Më pas, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Mexhide Mjaku-Topalli, Korab Sejdiu, Dardan Molliqaj, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi, Emilija Rexhepi, Danush Ademi, Salih

Salihu dhe Zenun Pajaziti, si dhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Dardan Molliqaj i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me premtimin e tij elektorale për liberalizimin e vizave. Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Frashër Krasniqi i parashtrroi pyetje ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo, në lidhje me vendndodhjen e tij gjatë luftës së fundit, përkatësisht gjatë viteve 1996-1999.

Ministri Nenad Rikalo nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Dardan Molliqaj i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me qëndrimet e mëhershme të ministrit Lekaj për Listën serbe.

Ministri Pal Lekaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Shqipe Pantina i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me çështjen e transportit publik për në Aeroportin e Prishtinës.

Ministri Pal Lekaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Arbërie Nagavci i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (Këshillit Shtetëror të Cilësisë).

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Hykmete Bajrami i parashtrroi pyetje ministrit të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, në lidhje me buxhetin dhe numrin e stafit të kësaj ministrie, si dhe ndarjen e detyrave me agjencinë KIESA.

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Hykmete Bajrami i parashtrroi pyetje ministrit të Financave, Bedri Hamza, në lidhje me respektimin e Ligjit për veteranët e luftës së UÇK-së, gjatë rishikimit të Ligjit për buxhetin për vitin 2017.

Ministri Bedri Hamza iu përgjigj pyetjes së deputetes.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet nga seanca konstitutive e mbajtur më 3, 4, 10, 14, 24 gusht dhe 7 shtator 2017 dhe të seancës së jashtëzakonshme, e mbajtur më 9 shtator 2017.

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2017 ka vendosur që seancës plenare t'ia propozojë Propozim-vendimin për formimin e 14 (katërbëdhjetë) komisioneve parlamentare.

Kryesuesi i hapi diskutimet lidhur me Propozim-vendimin për formimin e 14 (katërbëdhjetë) komisioneve parlamentare.

Lidhur me Propozim-vendimin për formimin e 14 (katërbëdhjetë) komisioneve parlamentare diskutuan: Memli Krasniqi, Albulena Haxhiu, Slobodan Petroviq, Islam Pacolli dhe Sami Kurteshi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Propozim-vendimin për formimin, emërtimin, numrin dhe strukturën e 14 (katërbëdhjetë) komisioneve parlamentare.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 82,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

për formimin e 14 (katërbëdhjetë) komisioneve parlamentare.

I. Formohen 4 (katër) komisione të përhershme, sipas emërimit dhe përbërjes, si në vijim:

a). Komisioni për Buxhet dhe Financa, 11 anëtarë:

1. Lumir Abdixhiku, kryetar (GP LDK),
2. Safete Hadërgjonaj, zëvendëskryetare e parë (GP PDK),
3. Jelena Bontiq, zëvendëskryetare e dytë (GP LS),
4. Dardan Molliqaj, anëtar (GP LVV),
5. Ali Lajçi, anëtar (GP LVV),
6. Mytaher Haskuka, anëtar (GP LVV),
7. Naser Osmani, anëtar (GP LDK),
8. Mërgim Lushtaku, anëtar (GP PDK),

9. Blerim Kuçi, anëtar, (GP AAK),
10. Enver Hoti, anëtar (GP “Nisma për Kosovën”) dhe
11. Mufera Srbica-Shinik, anëtare (GP “6+”).

b). Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, 12 anëtarë:

1. Igor Simiq, kryetar (nga komuniteti serb),
2. Xhelal Sveçla, zëvendëskryetar i parë (nga komuniteti shumicë, GP LVV),
3. Danush Ademi, zëvendëskryetar i dytë (nga komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, ashkali),
4. Kujtim Shala, anëtar (nga komuniteti shumicë, GP LDK),
5. Fadil Beka, anëtar (nga komuniteti shumicë, GP PDK),
6. Zoran Mojsiloviq, anëtar (nga komuniteti serb),
7. Jasmina Zhivkoviç, anëtare (nga komuniteti serb),
8. Sasha Milosavljeviç, anëtar (nga komuniteti serb),
9. Rasim Selmanaj, anëtar (nga komuniteti shumicë, GP AAK),
10. Albert Kinolli, anëtar (nga komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, rom),
11. Mufera Srbica-Shinik, anëtare (nga komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, turk) dhe
12. Duda Balje, anëtare (nga komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, boshnjak).

c). Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, 11 anëtarë:

1. Albulena Haxhiu, kryetare (GP LVV),
2. Hajdar Beqa, zëvendëskryetar i parë (GP PDK),
3. Bahrim Shabani, zëvendëskryetar i dytë (GP “6+”),
4. Glauk Konjufca, anëtar (GP LVV),
5. Sami Kurteshi, anëtar (GP LVV),
6. Arben Gashi, anëtar (GP LDK),
7. Korab Sejdiu, anëtar (GP LDK),
8. Agim Aliu, anëtar (GP PDK),
9. Jelena Bontiq, anëtare (GP LS),
10. Shkumbin Demaliaj, anëtar (GP AAK) dhe
11. Bilall Sherifi, anëtar (GP “Nisma për Kosovën”).

d). Komisioni për Integritet Evropian, 11 anëtarë:

1. Blerta Deliu-Kodra, kryetare (GP PDK),
2. Armend Zemaj, zëvendëskryetar i parë (GP LDK),
3. Fikrim Damka, zëvendëskryetar i dytë (GP “6+”),
4. Fitore Pacolli, anëtare (GP LVV),
5. Driton Çausi, anëtar (GP LVV),

6. Glauk Konjufca, anëtar (GP LVV),
7. Ilir Deda, anëtar (GP LDK),
8. Zenun Pajaziti, anëtar (GP PDK),
9. Adem Hoxha, anëtar (GP LS),
10. Ahmet Isufi, anëtar (GP AAK) dhe
11. Milaim Zeka, anëtar (GP “Nisma për Kosovën”).

II. Formohen 10 (dhjetë) komisione funksionale, sipas emërimit dhe përbërjes, si në vijim:

a). Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, 11 anëtarë:

1. Vjosa Osmani, kryetare (GP LDK),
2. Time Kadrijaj, zëvendëskryetare e parë (GP AAK),
3. Danush Ademi, zëvendëskryetar i dytë (GP “6+”),
4. Aida Dërguti, anëtare (GP LVV),
5. Visar Ymeri, anëtar (GP LVV),
6. Dukagjin Gorani, anëtar (GP LVV),
7. Doruntinë Maloku-Kastrati, anëtare (GP LDK),
8. Elmi Reçica, anëtar (GP PDK),
9. Evgjeni Thaçi-Dragusha, anëtare (GP PDK),
10. Srgjan Mitroviq, anëtar (GP LS) dhe
11. Zafir Berisha, anëtar (GP “Nisma për Kosovën”).

b). Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, 11 anëtarë:

1. Ismajl Kurteshi, kryetar (GP LVV),
2. Teuta Haxhiu, zëvendëskryetare e parë (GP AAK),
3. Mufera Srbica-Shinik, zëvendëskryetare e dytë (GP 6+),
4. Arbërie Nagavci, anëtare (GP LVV),
5. Adem Mikullovc, anëtar (GP LVV),
6. Valentina Rexhepi, anëtare (GP LDK),
7. Fidan Rekaliu, anëtar (GP LDK),
8. Abdyl Salihu, anëtar (GP PDK),
9. Nezir Çoçaj, anëtar (GP PDK),
10. Verica Çeraniq, anëtare (GP LS) dhe
11. Albulena Balaj-Halimaj, anëtare (GP “Nisma për Kosovën”).

c). Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, 11 anëtarë:

1. Sala Berisha-Shala, kryetare (GP PDK),
2. Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë (GP LVV),
3. Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë (GP LS),
4. Dardan Molliqaj, anëtar (GP LVV),
5. Qëndron Kastrati, anëtar (GP LVV),
6. Hykmete Bajrami, anëtare (GP LDK),
7. Mimoza Kusari-Lila, anëtare (GP LDK),
8. Memli Krasniqi, anëtar (GP PDK),
9. Gani Dreshaj, anëtar (GP AAK),
10. Bilall Sherifi, anëtar (GP “Nisma për Kosovën”) dhe
11. Duda Balje, anëtare (GP 6+).

d). Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, 11 anëtarë:

1. Daut Haradinaj, kryetar (GP AAK),
2. Besa Gaxherri, zëvendëskryetare e parë (GP LDK),
3. Srgjan Mitroviq, zëvendëskryetar i dytë (GP LS),
4. Liburn Aliu, anëtar (GP LVV),
5. Salih Salihu, anëtar (GP LVV),
6. Ali Lajçi, anëtar (GP LVV),
7. Lutfi Zharku, anëtar (GP LDK),
8. Andin Hoti, anëtar (GP PDK),
9. Ganimete Musliu, anëtare (GP PDK),
10. Enver Hoti, anëtar (GP “Nisma për Kosovën”) dhe
11. Danush Ademi, anëtar (GP 6+).

e) Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, 11 anëtarë:

1. Besa Baftiu, kryetare (GP LVV),
2. Enver Hoti, zëvendëskryetar i parë (GP “Nisma për Kosovën”),
3. Miljana Nikoliq, zëvendëskryetare e dytë (GP LS),
4. Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, anëtare (GP LVV),
5. Faton Topalli, anëtar (GP LVV),
6. Haxhi Avdyli, anëtar (GP LDK),
7. Naser Rugova, anëtar (GP LDK),
8. Flora Brovina, anëtare (GP PDK),
9. Bekim Haxhiu, anëtar (GP PDK),
10. Time Kadrijaj, anëtare, (GP AAK) dhe
11. Fikrim Damka, anëtar (GP “6+”).

f) Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, 11 anëtarë:

1. Nait Hasani, kryetar (GP PDK),
2. Shqipe Pantina, zëvendëskryetare e parë (GP LVV),
3. Jasmina Zhivković, zëvendëskryetare e dytë (GP LS),
4. Valon Ramadani, anëtar (GP LVV),
5. Fisnik Ismaili, anëtar (GP LVV),
6. Arban Abrashi, anëtar (GP LDK),
7. Imet Rrahmani, anëtar (GP LDK),
8. Xhevahire Izroku, anëtare (GP PDK),
9. Rasim Selmanaj, anëtar (GP AAK),
10. Milaim Zeka, anëtar, (GP “Nisma për Kosovën”) dhe
11. Albert Kinolli, anëtar (GP “6+”).

g) Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 11 anëtarë:

1. Haxhi Shala, kryetar (GP “Nisma për Kosovën”),
2. Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë (GP LVV),
3. Zoran Mojsilović, zëvendëskryetar i dytë (GP LS),
4. Xhelal Sveçla, anëtar (GP LVV),
5. Drita Millaku, anëtare (GP LVV),
6. Ismet Beqiri, anëtar (GP LDK),
7. Ramiz Kelmendi, anëtar (GP LDK),
8. Fatmir Xhelili, anëtar (GP PDK),
9. Fadil Beka, anëtar (GP PDK),
10. Blerim Kuçi, anëtar (GP AAK) dhe
11. Bahrim Shabani, anëtar (GP “6+”).

h) Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, 11 anëtarë:

1. Duda Balje, kryetare (GP 6+),
2. Lirije Kajtazi, zëvendëskryetare e parë (GP LDK),
3. Miljana Nikoliq, zëvendëskryetare e dytë (GP LS),
4. Frashër Krasniqi, anëtar (GP LVV),
5. Saranda Bogujevci, anëtare (GP LVV),
6. Mytahir Haskuka, anëtar (GP LVV),
7. Mirjeta Kalludra, anëtare (GP LDK),
8. Mexhide Mjaku-Topalli, anëtare (GP PDK),
9. Luljeta Veselaj-Gutaj, anëtare (GP PDK),
10. Teuta Haxhiu, anëtare (GP AAK) dhe

11. Albulena Balaj-Halimaj, anëtare (GP “Nisma për Kosovën”).

i). Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, 11 anëtarë:

1. Driton Selmanaj, kryetar (GP LDK),
2. Mërgim Lushtaku, zëvendëskryetar i parë (GP PDK),
3. Verica Çeraniq, zëvendëskryetare e dytë (GP LS),
4. Faton Topalli, anëtar (GP LVV),
5. Shqipe Pantina, anëtare (GP LVV),
6. _____, anëtar (GP LVV),
7. Avdullah Hoti, anëtar (GP LDK),
8. Andin Hoti, anëtar (GP PDK),
9. Blerim Kuçi, anëtar (GP AAK),
10. Zafir Berisha, anëtar (GP “Nisma për Kosovën”) dhe
11. Albert Kinolli, anëtar (GP 6+).

j) Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, 11 anëtarë:

1. Donika Kadaj-Bujupi, kryetare (GP LVV),
2. Ganimete Musliu, zëvendëskryetare e parë (GP PDK),
3. Bahrim Shabani, zëvendëskryetar i dytë (GP “6+”),
4. Arbër Rexhaj, anëtar (GP LVV),
5. _____, anëtar (GP LVV),
6. Anton Quni, anëtar (GP LDK),
7. Teuta Rugova, anëtare (GP LDK),
8. Xhevahire Izmaku, anëtare (GP PDK),
9. Slavko Simiq, anëtar (GP LS),
10. Bekë Berisha, anëtar (GP AAK) dhe
11. Haxhi Shala, anëtar (GP “Nisma për Kosovën”).

III. Fushëveprimi i komisioneve parlamentare sipas Shtojcës nr. 2 të Rregullores së Kuvendit harmonizohet në pajtim me këtë vendim.

5. Interpelanca e kryeministrit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ta informuar Kuvendin rreth akuzave publike të shfaqura ndaj ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin Ramush Haradinaj, për ta informuar Kuvendin rreth akuzave publike të shfaqura ndaj ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo.

Ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, tha se kryeministri është thirrur në interpelancë për të dhënë sqarime për akuzat publike për maltretim dhe torturim të qytetarëve shqiptarë, të ndodhur në vitet e paraluftës, të shfaqura ndaj ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo. Ai shtoi se institucionet e Republikës së Kosovës duhet të udhëhiqen nga njerëz që nuk kanë rënë ndesh me ligjin, e jo nga njerëz që akuzohen për dhunë e torturë ndaj qytetarëve të Kosovës. Duhet hetuar dhe sqaruar deklaratat publike të banorëve të lagjes “Dardania” në Prishtinë, të cilët kanë shfaqur dyshime se ministri Rikalo dhe anëtarë të familjes së tij gjatë viteve të okupimit dhe të masave represive të Milosheviqit ndaj shqiptarëve të Kosovës kanë fyer, kërcënuar dhe përdorur dhunë ndaj qytetarëve shqiptarë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkon përgjigje nga Qeveria: si janë trajtuar deklaratat e qytetarëve që kanë ngritur këto akuza publike, ngase këto akuza janë jashtëzakonisht të rënda. Kryeministri, në vend se ta shkarkojë menjëherë ministrin deri në qartësimin e akuzave publike të shfaqura, ka bërë deklaratime shfajësuese për ministrin Rikalo. Fjalimi i plotë është dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi kryeministrin që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me çështjen e ngritur në këtë interpelancë.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se menjëherë pas njoftimeve publike për mundësinë që ministri Rikalo të ketë qenë i involvuar në keqtrajtimet e qytetarëve gjatë luftës, si kryeministër i Republikës së Kosovës ka kërkuar informacione zyrtare nga mekanizmat përgjegjës të shtetit: Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria Speciale dhe nga Agjencia e Inteligjencës.

Ai shtoi se nga këto institucione ka marrë përgjigje se ato nuk kanë raste të raportuara, evidenca dhe asnjë shënim për rastet nga dyshimet publike për veprat e dyshuara dhe të raportuara në media për ministrin Nenad Rikalo. As nga Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, në buletinet për vitet 1999, 2000 dhe 2001, nuk ka ndonjë dëshmi, deklaratë apo provë që e inkriminon ministrin Rikalo për dhunë ndaj shqiptarëve në periudhën e luftës 1998-1999.

Diskutimi i plotë i kryeministrit Ramush Haradinaj është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për interpelancën e kryeministrit Ramush Haradinaj.

Për interpelancën e kryeministrit diskutuan këta deputetë: Xhelal Sveçla, në emër të GP të LVV-së; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Sasha Milosavljeviq, në emër të GP të Listës serbe; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së dhe Bilall Sherifi në emër të GP të “Nismës për Kosovën”, si dhe deputetët: Albin Kurti, Naser Rugova, Andin Hoti, Avdullah Hoti, Slavko Simiq, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka, Shkumbin Demaliaj, Donika Kadaj-Bujupi, Korab Sejdiu, Glauk Konjufca, Ganimete Musliu, Labinot Tahiri, Rexhep Selimi, Besa Gaxherri, Emilija Rexhepi, Ali Lajçi, Hajdar Beqa, Igor Simiq dhe Liburn Aliu, si dhe kryeministri Ramush Haradinaj, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Në fund, kryeministri Ramush Haradinaj dha sqarime shtesë lidhur me dabatin e zhvilluar.

Pas këtyre diskutimeve, Avdullah Hoti, në emër të propozuesit të interpelancës, e paraqiti tekstin e mocionit për votim, si në vijim:

1. Kryeministri ta shkarkojë menjëherë ministrin Rikalo.
2. Institucionet kompetente, në përputhje me ligjet në fuqi, t’i hetojnë akuzat e ngritura nga banorët e lagjes “Dardania” në Prishtinë kundër ministrit Rikalo.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e tekstit të mocionit të propozuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 27,
Kundër ----- 40,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi tekstin e mocionit të propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në lidhje me akuzat publike të shfaqura ndaj ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 16:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*